



Pjesa e parë: Koha e syfyrit

- 1- Ngritja para agimit një orë apo gjysmë ore më herët.
- 2- Ngritja për ngrënien e syfyrit duke pasur parasysh bereqetin e tij.
- 3- Abdesi, falja e dy rekateve, lutjet dhe kërkim-falje (istigfari), Allahu ka thënë:” dhe në syfyr (kah mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkate”. Dharijat:18
- 4- Shkuarja në xhami për të falur namazin me xhemat (sa i përket meshkujve)
- 5- Përsëritja e ezanit pas muezinit dhe leximi i lutjes pas përfundimit të ezanit, poashtu edhe dërgimi i salavateve Muhamedit alejhi salam.
- 6- Dhikri pas namazit.
- 7- Lutja, namazi i duhasë, përmendja e Allahut dhe leximi i një pjese nga Kurani.
- 8- Prej namazit të duhasë deri në dreke kohe e lirë për: lexim, punë, nxënie përmendësh, lexim të ndonjë tefsiri apo libri të haditheve dhe pushim.

Pjesa e dytë: Dreka

- 1- Përsëritja e ezanit pas muezinit dhe leximi i lutjes pas përfundimit të ezanit, poashtu edhe dërgimi i salavateve Muhamedit alejhi salam.
- 2- Falja e katër suneteve para dhe dy pas farzit.
- 3- Lutja dhe dhikri pas namazit
- 4- Leximi i një pjese nga Kurani.

Pjesa e tretë: Ikindia

- 1-Perseritja e ezanit pas muezinit dhe leximi i lutjes pas përfundimit të ezanit, poashtu edhe dërgimi i salavateve Muhamedit alejhi salam.
- 2- Pushimi, sepse edhe trupi ynë ka hak.
- 3- Kujdesi për punët e shtëpisë dhe ndihma e bashkëshortes që edhe ajo të ketë mundësi të përfitojë në këtë muaj të shenjtë.
- 4- Para akshamit për disa çaste të bëjmë lutje dhe të lexojmë Kuran.

Pjesa e katërt: Akshami

- 1- Shkuarja për të falur namazin e akshamit në xhami edhe pse, për fat të keq, kjo pak praktikohet te ne gjatë Ramazanit.
- 2- Prishja e agjërit me hurma për ata që kanë mundësi. Nëse nuk ka hurma, atëherë me ujë, me këtë duke pasur qëllim pasimin e Muhamedit alejhi selam.
- 3- Përsëritja e ezanit pas muezinit dhe leximi i lutjes pas përfundimit të ezanit, poashtu edhe dërgimi i salavateve Muhamedit alejhi selam.
- 4- Tubimi me familjarët në sofrën e iftarit.

Pjesa e pestë: Jacia

- 1- Përsëritja e ezanit pas muezinit dhe leximi i lutjes pas përfundimit të ezanit, po ashtu edhe dërgimi salavate Muhamedit alejhi selam.
- 2- Falja e namazit në xhami.
- 3- Falja e namazit të teravive.
- 4- Ndeja me familjarët.
- 5- Leximi i një pjese nga Kurani para gjumi.
- 6- Fjetja herët ashtu që të kesh mundësi të ngrihesh i freskët për adhurim.

Përgatiti: Valdet Kamberi